

CREDINS BANK STRUKTURË DINAMIKE DHE VOLUM

TASHMË, CREDINS BANK OFRON SHËR-
BIMET BANKARE PËR KLIENTËT E SAJ, NË
GODINËN E RE ME KONCEPT VOLUMOR
DHE ARKITEKTONIK DINAMIK QË DUKET
SE RREZATON NJË ENERGJI POZITIVE NË
KAOSIN E MADH TË ZONËS SË ISH-BLLO-
KUT! KJO DUKET SE PËRCJELL NJËHERËSH
EDHE IDENË SE OBJEKTE TË TILLA NË TË AR-
DHMEN MUND TË JENË PJESË E PËLHURËS
URBANE TË TIRANËS.

Të gjithë që kanë kaluar qoftë edhe një herë të vetme në zonën më strategjike të kryeqytetit, siç është dhe ish-Blloku, me shumë gjasa që i ka tërhequr godina me strukturë të veshur me fasada xhami dhe ngjyrë mente. Dhe e gjithë merita shkon për studion e famshme arkitekturore franceze "Architecture Studio", por edhe për studion shqiptare "Avatelier", që kanë definuar një koncept arkitekturor tejet të veçantë. Një objekt i konceptuar mjaft mirë nga ana volumetrike, dhe mbi të gjitha në një ambient me sinergji bashkëpunimi pozitive ndërmjet investitorëve, firmës së ndërtimit dhe projektuesve. Kryetari i Shoqatës së Arkitektëve të Shqipërisë, Prof.Asoc. Armand Vokshi, shprehet se kjo godinë e filialit të ri të Credins Bank në Tiranë, është plazmuar nga francezët brenda parametrave të arkitekturës bashkëkohore. Lartësia e moderuar në raport me kontekstin dhe linjat e pastra, por mjaft dinamike e bëjnë atë një nga objektet më të arrira në kryeqytet.

Cila ishte ideja juaj fillestare në lidhje me aspektin arkitekturor të godinës së Bankës Credins në kryeqytet në zonën e ish-Bllokut? Objekti i sotëm është rezultati mbivendosjes së punës projektuese të disa arkitektëve, të cilët janë marrë me të në kohë të ndryshme. Konceptimi i jashtëm volumor dhe arkitektonik është produkt i studios së famshme franceze Architecture Studio shumë vite më parë. Ndërkohë që pjesët e interiorit, për t'i përshatur në ambientet e brendshme të Credins Bank u projektuan e realizuan përkatësisht nga dy studio shqiptare, ku: pjesa e hollit të hyrjes, i gjithë kati përdhe dhe ambjentet e katit të parë nën tokë u studiuan e realizuan nga studio jonë "Avatelier", ndërkohë që të gjitha katet e sipërme të zyrave qendrore të bankës u realizuan nga studio e arkitektes Anila Kokona. Kështu pra, duke filluar nga ideja fillestare e studios franceze, mund të themi që ishte mjaft interesante, pasi ata arritën që, me një gjest të thjeshtë volumor të zgjidhnin marrëdhënien e objektit me kryqëzimin dhe me qoshen në të cilën ndodhej objekti. Baza e godinës me planimetri thuhetse katrore, u nda në dy volume me baza trekëndore, të cilët trajtoheshin të pavarura, por të lidhura midis tyre si dy volume dinamike që ngriheshin në lartësi. Ato janë të pasqyruara në mënyrë antimetrike me njëra-tjetrën dhe



për të theksuar më shumë diferencën midis tyre, kanë operuar në epidermë me materiale totalisht të ndryshme. Në pjesën e veriut dhe të veri-lindjes ndodhet volumi i xhamtë, totalisht i ekspozuar e transparent, kjo edhe për motivin e diellëzimit më të pakët, në raport me pjesën tjetër, e cila ndodhet në jug dhe jug-perëndim. Për këtë arsye kjo pjesë është trajtuar me një lojë harmonike dritaresh të gjata e të ngushta, si pjesë e një gridi panelesh të trajtuara me një material bazë bakri, ngjyrë gur-kali. Për herë të parë në Shqipëri kemi prezencën e një veshjeje të tillë të një ndërtese, ku pjerrësia e faqeve të jashtme ishte një vështirësi më vete gjatë realizimit.

Çfarë stili arkitekturor emeton kjo godinë?

Natyrisht që godina është plazmuar nga francezët tërësisht brenda parametrave të arkitekturës bashkëkohore, sipas një tipologjie internacionale të padefinueshme qartë. Gjithsesi, lartësia e moderuar në raport me kontekstin dhe linjat e pastra, por mjaft dinamike e bëjnë atë një



nga objektet më të arrira në Tiranë. Ai rrezaton një energji pozitive në kaosin e madh të ish-Bllokut dhe jep shpresë se mund të realizohen e integrohen edhe objekte të tilla në të ardhmen në pëlhurën urbane të Tiranës.

A keni pasur influenca të jashtme stilistike, për t'i implementuar ato mandej në realitet?

Projekti për realizimin e Credins Bank ka qenë një proces të mëvonshëm adaptimi, brenda volumeve të projektit francez, të cilët e kishin nisur projektin fillestar si një godinë me funksione të miksuara. Interesante është konçidencja e objektit në plan, i cili duket sikur është gjeneruar nga logo e vetë Bankës, si ndërthurje e dy trekëndëshave. Ndërkohë që për sa i përket pjesës së projektuar nga ne, në ambientet e interierit, produkti i realizuar ka qenë frut i konsideratave të shumta konceptuale, në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me drejtuesit kryesorë të Credins Bank, zotit Maltin Korkuti dhe zonjës Monika Milo. Tendencja jonë projektuese ishte kërkimi i thellë në evidentimin

e disa elementeve bazësi funksionale e arkitekturore ashtu edhe në materiale, të cilat më vonë do të ktheheshin në imazhin e Bankës edhe në filalet e tjera. Në fakt ne donim patjetër një ndryshim radikal të imazhit të deritanishëm me të cilin prezantohej banka.

Fasadat e xhamit, nuancat e pastra, e theksojnë luksin e detajeve, stilin e refiniturave në tërësi. Si ia keni dalë ta materializoni atë praktikisht?

Nuk ka qenë e lehtë, por ka qenë një kënaqësi mjaft e veçantë të punoje në një objekt të konceptuar mjaft mirë nga ana volumetrike dhe më pas ka qenë një ambient me sinergji bashkëpunuese mjaft pozitive midis investitorëve, firmës së ndërtimit dhe projektuesve. Pra është një materializim i një dashurie të trefishtë për një objekt funksional e harmonik njëkohësisht.

Çfarë risish mendoni se keni sjellë përmes këtij projekti?

Mendoj se merita kryesore i kalon studios







franceze për idenë mjaft të goditur në trajtimin e volumeve e materialeve. Ne shpresojmë nga ana jonë që punonjësit e bankës të ndihen mirë në këto ambjente, pasi janë ata të cilët kalojnë gjithë ditën në këto ambjente. Duke u ndier mirë ata do të punojnë më mirë e do jenë më efikasë në punën e tyre.

Si është realizuar ndarja e hapësirave të brendshme të bankës, sipas sektorëve specifik?

Ndarja e ambjenteve dhe akomodimi i të gjithë sektorëve ka qenë një dilemë më vete dhe është realizuar në sintoni të plotë me zyrën e Burimeve Njerëzore dhe arkitektëve të të dy studiove shqiptare.

Pjesa më e veçantë në gjithë godinën, qoftë në pjesën e eksterierit apo edhe interiorit?

Vështirë të ndahen pjesë të veçanta të objektit, pasi çdo pjesë ka veçantinë e vet në raport me të tërën, por mendoj që pjesa e bashkimit të dy volumeve, e cila kthehet në hyrjen e objektit, në aks me kryqëzimin e jashtëm të rrugëve, është pjesa ime e preferuar. Ajo pjesë është akoma e papërfunduar, pasi aty është rezervuar edhe vendi i një skulpture me përmasa të konsiderueshme që do ta theksojë imazhin e pjesës hyrëse për në objekt. Credins Bank sapo ka organizuar një konkurs të hapur publik për këtë vepër arti dhe jemi në momentin e seleksionimit të fituesve. Me siguri që kjo skulpturë do t'i shërbejë edhe qytetit.